



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 15/18
Prishtinë, më 24.1.2018, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Ali Lajqi, Naser Osmani, Blerim Kuqi, Mërgim Lushtaku, Envere Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Dardan Molliqaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza - Ministër i Financave (tutje: Ministri), Lulëzim Rafuna - Këshilltar në MF, Salvador Elmazi, Drejtor i Buxhetit në MF, Besnik Osmani AP, Nebih Zariqi anëtar i Bordit të Drejtorëve në KOSTT, Kadri Kadriu - u.d. Kryeshef Ekzekutiv në KOSTT, Nebih Haziri, Zyrtar Kryesor i Financar në KOSTT.

Pjesëmarrës të tjerë: Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: Kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 15.01.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;**
- 5. Shqyrtimi Raportit vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të KOSTT SH.A. për vitin 2016;**
- 7. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për periudhën shtator-dhjetor 2017;**
- 8. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2018;**
- 9. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – siç jeni të njoftuar edhe përmes email-it nga stafi, propozojë që të plotësohet rendi i ditës me këtë çështje: Shqyrtimi i Propozimit të Panelit të Bankës Qendrore, për përgjedhjen e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht vendosi që të plotësohet rendi i ditës, me një pikë të re 9, si në vijim: Shqyrtimi i Propozimit të Panelit të Bankës Qendrore për përgjedhjen e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajture e Komisionit, dt. 15.1.2018

Kryetari - konstatoi se Komisioni unanimitisht miratoi procesverbalin e mbledhjes së komisionit, dt. 15.01.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2018;

Kryetari - siç jemi të njoftuar, Kuvendi Komunal i Lipjanit, nuk ka arritur ta votojë Buxhetin e Komunës brenda afatave ligjore për vitin 2018 dhe si rezultat në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Buxheti i Komunës së Lipjanit është përfshirë në Buxhetin e Kosovës 2018 në shumat e vitit paraprak, pra 2017. Qeveria e Kosovës ka dërguar në Kuvend, buxhetin e Komunës së Lipjanit, të miratuar nga Kuvendi Komunal i kësaj komune, me datë 18.12.2018. Në bazë të shkresës sqaruese të Ministrisë së Financave të bashkangjitur vendimit të Qeverisë, thuhet se Kuvendi Komunal i Lipjanit ka miratuar Buxhetin e Komunës së Lipjanit për vitin 2018-2020, në pajtueshmëri me kufijtë buxhetor të përcaktuar me qarkoret buxhetore 2018/-01 dhe 02, si dhe kriteret për ndarjen e buxhetit për komunat në pajtim me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal. Duhet të përkujtojmë një procedurë e tillë ka ndodhur edhe në vitin 2015 dhe 2016, ku Komisioni ka shqyrtuar buxhetin komunës se Prishtinës, Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveqanit, Glllogocit e Klllokotit, ku më pastaj komisioni ka nxjerrë rekomandime për Ministrinë e Financave.

Bedri Hamza – theksoi se Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar buxhetin e komunës së Lipjanit, të miratuar nga komuna me dt. 18.12 2017 në pajtim me kushtet që parashihen me nenin 62 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Buxheti i komunës së Lipjanit në 2018 është 15,631,939 euro nga 14,250,253 euro sa ka qenë në vitin 2017 dhe bëhet fjalë për një ndryshim prej 1,606.631 euro. Të bashkangjitur e keni edhe tabelat buxhetore për këtë komunë. Duhet të theksojmë se Kuvendi i Lipjanit e ka aprovuar buxhetin pas aprovimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës 2018, nga Kuvendi i Kosovës dhe Ministria e Financave rekomandonë që të aprovohet buxheti për Komunën e Lipjanit për viti 2018.

Kryetari – theksoi se në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, ekziston një tabelë ku tregon ndër të tjera edhe për buxhetin e tri komunave që nuk është aprovuar me kohë, dhe në pajtim me ligjin është vendosur buxheti i vitit 2017 për këto komuna, si dhe kemi të dhëna edhe për ndryshimin e buxhetit të këtyre komunave në raport me kufizimet e përcaktuara me qarkoret buxhetore.

Naser Osmani - nëse ka ndryshime në tabelat buxhetore, ndoshat duhet kaluar në Kuvend.

Bedri Hamza - sqaroi se Buxheti i Komunës së Lipjanit është aprovuar në përputhje me qarkoret buxhetore dhe nuk ndikon në kufijtë buxhetor të Buxhetit të Kosovës.

Kryetari - në bazë të informatave, në shqyrtimin e buxhetit të komunave që e kanë aprovuar me vonesë, ka qenë raste të ngjashme, ku buxheti i tyre ka qenë sipas qarkoreve buxhetore, dhe lënda nuk ka shkuar në seancë, por Komisioni ka vendosur dhe ka nxjerrë rekomandim për Ministrinë e Financave.

Blerim Kuçi – unë propozoj që të veprojmë sipas praktikave të deri tanishme, si ka vepruar komisioni në raste të tilla.

Bedri Hamza – ne si ministri e financave ne përputhje me ligjin e kemi proceduar buxhetin e Komunës në fjalë në Qeveri e pastaj ka ardhur në Kuvend.

Safete Hadërgjonaj - ne edhe në vitet e kaluara kemi pas një raste gati si të njëjta në 2 apo 3 komuna, por unë nuk e kam informatat a ndryshojnë tabelat në bazë të amendamenteve që kemi miratuar për projektet në Komunën së Lipjanit. Ne si Komision është pak problem me dërgu rekomandimin direkt në qeveri, pa kaluar në Kuvend, në rast se kanë ndryshuar tabelat buxhetore. Nëse nuk kanë ndryshuar tabelat buxhetore është normale që mos me procedue në Kuvend se nuk ka ndryshua a asgjë.

Bedri Hamza - sa i përket buxhetit të Komunës së Lipjanit nuk e ndikon në tabelat tjera që janë pjesë e Ligjit të Buxhetit të Kosovës për vitin 2018. I vetmi ndryshim ndodh tek buxheti i Komunës së Lipjanit, për shkak se edhe grandet kanë qenë të parapara me qarkoren buxhetore.

Kryetari - po propozoj që e ndjekim të njëjtin logjikë dhe praktikë siç ka vepruar komisioni në legjislaturën e kaluar, kur ka shqyrtuar buxhetet e komunave tjera dhe rekomandojë Ministrisë së Financave, që Buxheti i Komunës së Lipjanit për vitin 2018, i miratuar nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, më datë 18.12.2017, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Ministrisë së Financave, që Buxheti i Komunës së Lipjanit për vitin 2018, i miratuar nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, më datë 18.12.2017, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës

Kryetari - çështja kryesore e plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për Presidentin është harmonizimi përfitimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës me përfitimin e ish zyrtarëve tjerë të lartë. Si rrjedhojë me nenin 2 të projektligjit, është hequr kufizimi nga ligji bazik, prej pesë vjeçar, i mundësisë së beneficioneve të Presidentit që i ka përfunduar mandati, në hapësirë pune, në pajisje për zyre, dhe në personel profesional të zyrës deri në tre (3) persona. Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave ka vlerësuar se nga aspekti i ndikimit buxhetor, projektligji përmban kosto shtesë buxhetore prej 66,543 euro për periudhën 2018-2020, duke përfshirë vitin 2017, kur është bërë vlerësimi i ndikimit buxhetor, si nevojë për punësimin e tre punëtorëve të rinj.

Bedri Hamza - sa i përket aspekti të ndikimit buxhetor dhe financiar të projektligjit spozorizuese e të cilit është Zyra e Kryeministrit, e cila në momentin që ka bërë vlerësimin fillestar dhe që ka ndodhur në vitin 2017, ka deklaruar se ka kosto buxhetore shtesë prej 81,543 € në totale për periudhën 2017-2020

dhe punësimin e tre punëtorëve të rinj. Ministri e Financave, respektivisht Departamenti i Buxhetit, po ashtu ka dhënë opinionin e vetë ku ka konfirmuar koston shtesë buxhetore. Mirëpo, Opinioni i Departamentit të Buxhetit është bërë bazuar në buxhetin e vitit 2017, ku numri i të punësuarve në Zyrën e Presidentit ka qenë i aprovuar 70, e tash me Ligjin e Buxhetit 2018 numri i aprovuar i të punësuarve është 80 dhe rrjedhimisht kostoja shtesë prej 3 punëtorëve mund të akomodohet mbrenda ndarjeve ekzistuese buxhetore. Ne si Ministri e Financave vlerësojmë se Projektligji nuk përban ndonjë kosto të lartë buxhetore që e ngarkon Buxhetin e Republikës së Kosovës apo e rrezikon stabilitetin makro-fiskal.

Kryetari - propozojmë që Komisioni të nxjerrë rekomandimin se s projektligji Projektligjin nr.06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, përban kosto të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, përban kosto të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi Raportit vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016

Kryetari - në bazë të nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Zyra e Auditimit të Kosovës (ZKA), brenda katër muajve pas përfundimit të secilit vit fiskal duhet t'i dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës një raport mbi veprimtarinë e saj gjatë vitit.

Besnik Osmani - theksoi se sa i përket strukturës së shpenzimeve për mallra dhe shërbime kemi pasur shpenzimet rreth 97%, pjesa më madhe e shpenzimeve shkojnë për qira rreth 31%, për mbulimin e shpenzimeve në punën në teren për auditor, ku përfshin akomodimet, shujta, transport, pajisjet për përdorin nga auditorët pra janë rreth 20% shpenzime operative për nevojat e auditorëve. Raporti i auditorit të jashtëm për ZKA-në bazohet në opinionin e pakualifikuar. Ne kemi arritur të sigurojmë disa donacione të jashtme nga Bashkimi Evropian dhe buxheti prej 85,000 euro, si kursim është kthyer në buxhetin e Kosovës. Por gjatë këtij viti kemi pasur një përshtatje të buxhetit, ka qenë një ulje e shpenzimeve të kontraktuara për kryerjen e auditimeve nga kompanitë private, dhe auditimet në komuna dhe ndërmarrjet publike (përfshirë edhe ato në nivel komunal) janë bërë nga auditorët e ZKA-së, gjë që ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve të udhëtimit që kanë qenë 114% dhe diferenca në total është 435 euro

Kryetari - qiraja prej 10,000 euro në muaj apo 31% e buxhetit total me u shpenzue për qira është shumë e madhe. Në kuadër të kësaj çështje, kam një pyetje, a keni bërë kërkesë në Kryeministri apo në institucionet tjera përgjegjëse që me e zgjidh problematikën e objektit të institucionit tuaj?

Besnik Osmani - prej marrjes së mandati të auditorit, kam përcjellur shkresa me shkrim dhe verbale në Qeveri, Kuvend por edhe Kuvendit Komunal të Prishtinës, për me shikue hapësirat që janë boshë dhe e fundi të që e kam adresuar kërkesën është dje tek Komuna e Prishtinës që nëse është e mundur me na dhënë objektin e ish shkollës ekonomike që është objekt i lirë, i demoluam, i papërdorshëm që të të renovohet dhe të vendosemi aty. Pra, Zyra jonë Kombëtare është themelua në 2003 dhe nga atëherë është me qira dhe deri me tani janë paguar më shumë se 2.9 milion euro për qira.

Enver Hoti - theksoi se është për t'u përshëndetur puna e juaj si institucion, por iu kisha bashkangjitur shqetësimeve për qiranë e lartë dhe kam një pyetje për ju auditor, çfarë keni ndërmarrë konkretisht në këtë drejtim, për të siguruar një objekt shtetëror?

Besnik Osmani – theksoi se e kam takuar Ministrin e Administratës Publike për qëllimin e objektit disa herë, kemi punuar me rektoratin e universitetit që e ka një objekt të zbrazët që mundemi me përdorë dhe kemi kërkuar që ta marrim edhe mendimin e qeverisë, mirëpo nuk kemi arritur rezultate konkrete. Ne kemi 150 auditorë dhe në objektin ku gjindemi është i pamjaftueshëm, pasi që në fillim kemi qenë 110 të punësuar e tani jemi 160. Po ashtu kam siguruar katër projekte që na ndihmojnë në punën tonë dhe kemi vetëm një sallë ku e bëjmë gjithë aktivitetin.

Safete Hadërgjonaj - theksoi se vërtetë është shqetësuese që 3 milion euro me paguë qira dhe mos të kemi një objekt për këtë zyrë, që e përfaqëson edhe shtetin tonë. Ne kudo që kemi shkuar nëpër vizita jashtë shtetit dhe kemi pas vizita edhe në institucionet e auditimit, nuk kemi hasur asnjë rast që një institucion i tillë është me qira, por përkundrazi kanë pasur objekte reprezentative. Prandaj, është mirë edhe ne si Kuvend të bëjmë presion tek institucionet qeveritare, por edhe tek Komuna e Prishtinës, sepse qenka një mundësi e mirë në shkollën ekonomike që qenka e papërdorur, që me u vendos kjo zyrë dhe me pas një adresë të vetën.

Auditori paraprak në vazhdimësi na ka bërë vërejtje se zyra e auditorit nuk po trajtohet mirë, për pagat nën nivel, ndërsa unë po shoh se paga mesatare është 873 euro për auditor, kam një pyetje si qëndron puna me auditorët, a keni staf të mjaftueshëm dhe a keni nevojë për përkrahje shtesë nga komisioni dhe Kuvendi, pasi që kemi nevojë që të kemi një zyrë të fuqishme të auditorit sepse është një zyrë e rëndësishme për performacën dhe kontrollin e financave publike.

Një çështje tjetër ka të bëjë me tejkalimin e shpenzimeve për paga dhe mëditjeve për numrin e të punësuarve dhe po vërehet se ky tejkalim është për shkak grave të pushimit të lehonisë dhe zëvendësimit të tyre. Po më intereson si Zyra e Auditimit, cilat janë të gjeturat e juaja në këtë fushë, sa përballen institucionet tona me këtë problem të zëvendësimit me gratë që shkojnë në pushim të lehonisë? Kjo problematikë është më e theksuar në zëvendësimet e mësuesve në shkolla. Një çështje tjetër janë shtimi i punëtorëve me kontratat mbi vepër si në institucionet qendrore po ashtu dhe në ato lokale, dhe për mua është shqetësuese që një komune e vogël me i pas 73 punëtor me kontratë mbi vepër. A keni bërë ndonjë analizë, se me çfarë fonde paguhen këta punëtorë në kontrata mbi vepër, a paguhen nga fondi i pagave dhe mëditjeve apo mallrave dhe shërbimeve, dhe cilat janë shkeljet që bëhen në këtë fushë?

Berim Kuçi - ne për shqyrtimet e raportet të tilla financiare për institucionet tjera jemi bazuar në raportin e auditorit të përgjithshëm. Ju z.Osmani thatë se Rapori i auditimit për Zyrën e Auditorit është i pakualifikuar, por do të ishte mirë me ja bashkangjitur raportit financiar edhe raportin e auditimit të jashtëm. Kur thuhet se 31% e buxhetit shkon për qiranë, më intereson të dijë se a ka ndonjë rekomandim prej auditorit të jashtëm për këtë çështje? Pra, do të ishte më interes të kishim raportin e auditimit lidhur me vlerën e qirasë karshi kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, e tek pastaj ne mundemi me i dhënë rekomandimet tona lidhur me këtë çështje dhe çështjet tjera?

Ali Lajçi – theksoi se raporti është i mirë, por është brengosëse shuma e qirasë. Ne po ashtu kemi shumë institucionet tjera që rrinë nëpër objekte të ndryshme private e paguajn qira me kosto të madhe. Prandaj, si komision duhet ti rekomandojmë ministrisë përgjegjëse për administratë publike, që të bëjnë një listë rreth objekteve të mundshme shtetërore rreth objekteve që paguhen qira, se sa është shuma kalkuluese e gjitha atyre që paguajnë qira dhe cila është alternativa e mundshme për ti nxjerrë ato që kanë uzurpuar institucionet shtetërore, dhe për ti vendosur institucionet në objekte shtetërore.

Naser Osmani – konsiderojë se komisioni për buxhet dhe financiar ne kontinuitet qysh prej fillimit të Zyrës së Auditimit, ka qenë i angazhua me i ndihmue në çdo aspekt këtij institucioni që është ndër institucionet më të rëndësishme kushtetuese shtetërore. Tani jemi në një situatë me fol vetëm për kushtet e objektit dhe unë mendojë që institucionet e tilla, siç janë Gjykata Kushtetuese, BQK, Auditori Gjeneral me pas objekte reprezentative sepse paraqesin edhe kulturën shtetërore. Prandaj, propozojë që në emër të komisionit me e ngrit këtë çështjen e objektit e me ju drejtua Komunës se Prishtinës dhe Qeverisë.

Kryetari – në emër të komisionit do t'i dërgojë shkresë Komunës së Prishtinës lidhur me sigurimin e një objekti për Zyrën Kombëtare të Auditimit, e dyta do të ftojme Ministrinë e Administratës Publike për raportim dhe që të na sjellë një listë të objekteve që janë me qira dhe objektet që janë të pashfrytëzuara dhe e treta shqetësimin e kostos së madhe të pagesës së qirasë të institucioneve shtetërore, do ta paraqes me rastin e arsytimit e rekomadimit të komisionit në seancë kur të shqyrtohet raporti vjetor financiar i ZKA-së për viti 2016.

Safete Hadërgjonaj - nëse pajtohen te gjithë anëtarët që takimin me Ministrin e Administratës Publike për çështjen e qirasë ta fusim në planin e punës dhe ne ta bëjmë edhe një kërkesës për ministrin që të na ofrojë informata me shkrim se cilat institucione janë duke e zhvilluar aktivitetin e vetë me qira, ku janë këto institucione te vendosura, sa mjete shpenzohen për qira brenda viti dhe sa na kushton pagesa e qirasë në buxhetin e Kosovës.

Besnik Osmani – theksoi se zgjidhja e objektit është e domosdoshme. Sa i përket raportit të auditimit për ZKA-në unë e kam dorëzuar raportin e auditorit të jashtëm në Kuvend brenda afatit ligjor dhe e kam publikuar edhe në web faqen e tonë. Sa i për ketë pyetjes që u shtrua rreth trajtimit me paga me Zyrën Kombëtare të Auditimit mundem me konstatue qe Parlamenti dhe Qeveria e Kosovës e trajtojnë në mënyre të dinjitetshme auditorin, por sigurisht se kjo nuk është i bollshëm për një arsye të vetme pasi që është një punë specifike dhe auditorët janë shumë të kërkuar në treg dhe jo lehtë që ti mbajmë në punë një staff të kualifikuar. Sa i përket pushimeve të lehonisë, sot para dite kur po punoja në planin e auditimit pranveror dhe kemi 120 auditorë, e prej tyre 17 në pushim të lehonisë dhe është çështje që sigurisht ndikon në punën tonë.

Sa i përket kontratave mbi vepër, në raportet tona ne kemi evidentuar mjaftë shkelje në këtë fushë, dhe atë: se për këta punëtor nuk janë të buxhetuara mjetet në shumë raste, se këta punëtor duhe të rekrutohen për qëllime specifike dhe me afat të caktuar jo ma shumë se gjashtë punë, të merren në punë për qëllime universale dhe ordinere dhe jo më shumë se gjashtë muaj, dhe duhet pasur një procedurë të thjeshtësuar të konkurimit dhe të transparencës, e cila në shumë raste rekrutimi i tyre, bëhet pa i respektuar këto dy kritere.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016.

6. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të KOSTT SH.A. për vitin 2016

Kryetari – theksoi se në bazë të nenit 13 paragrafi 5 të Ligjit për Energji Elektrike nr. 05/L-085 KOSTT, i dorëzon raportin vjetor Kuvendit të Republikës së Kosovës, më se largu deri më 30 qershor të

vitit aktual për vitin paraprak. Kërkojë nga përfaqësuesit e KOSTT të bëjnë prezantimin e raportit financiar.

Nebih Zariqi – theksoi se KOSTT-it se ai luan një rol mjaft të rëndësishëm në fushën që rregullon, përbëhet nga një staf profesional këtë e tregon më së miri edhe rezultati i raportit vjetor financiar i vitit 2016. KOSTT nuk ka kryetar dhe zëvendës-kryetar të emëruar në detyrë dhe Bordi përbëhet vetëm nga tre antarëve të cilët dy nga ta sot nuk kanë ardhur. Në bazë të ligjit të ri për energji elektrike aksionar është Kuvendi.

Kryetari - dy antarët e bordit nuk janë prezent, dhe kërkojë nga administrata ti dërgohet nga një letër atyre për të treguar se për çfarë arsye nuk kanë ardhur.

Naser Osmani – në materialin që kemi të bashkangjitur, raporti financiar nuk është përgaditur sipas formës standarde dhe propozojë që të shtyjë këtë pikë për një mbledhje tjetër dhe të kërkojë nga KOSTT të përgadit raportin financiar sipas formës standarde.

Safete Hadërgjonaj - theksoi se më herët aksionar i KOSTT-it ka qenë Qeveria, ndërsa me ndryshimet e ligjit aksionar është bërë Kuvendi, dhe i raporton atij. Raporti i KOSTT-it për vitin 2016, përmban mjaftë të dhëna të cilat janë të nevojshme që ne ti shohim, mirëpo për institucionet dhe agjencitë e pavarura që raportojnë në Kuvend ne kemi një formular standrad në bazë të cilit ato raportojnë në Kuvend. Prandaj, propozojë që të shtyjë këtë pikë të rendit të ditës, administrata t'iu dërgojë formularët KOSTT-it dhe të përgadis raportin financiar në bazë të këtyre formularëve dhe e shqyrtojë atë në një mbledhje tjetër.

Enver Hoti – theksoi se e mbështes plotësisht mendimet e kolegëve që të shtyhet raporti për një mbledhje tjetër. Kam një pyetje se a keni marrë pjesë në bisedimet në Bruksel, sepse ajo që po bisedohet dhe që po arrihet marrëveshje, edhe për bisedimet teknike, ne kemi marrur përgjigje retorike nga ish qeveria. Duhet ta kemi një shtesë me këto informata, si dhe të bashkangjitet një raport shtesë financiare, pastaj ne do të japim mendimin tonë për raportin.

Mërgim Lushtaku – në fillisht duhet ta dijmë se kur është miratuar ligji i ri për KOSTT-in, a është për vitin 2017 apo edhe për vitin 2016. Nëse ligji nuk është miratuar në vitin 2016, atëherë raportin duhet ta shqyrtojë qeveria, pasi që deri në atë kohë ky institucion i ka dhënë llogari qeverisë. Pas këtij sqarimi ligjor, atëherë ne mund të kërkojmë që të raportohet sipas formës standarde të raportimit financiar që kërkojë për raportim në këtë komision dhe Kuvend.

Blerim Kuqi – mendojë se duhet ti shikojmë ato fazat e tranzicionit të raportimit, si rezultat i ndryshimit të ligjit, për të parë se a duhet KOSTT-i të raportojë në Qeveri apo Kuvend. Raporti mua po më pëlqen. Por nëse komisioni i ka format standarde të raportimit ne mund të kërkojmë që të përgaditet edhe në atë formë, por jo të flitet se a është apo jo raporti i mirë. Si dhe duhet të kemi sqarimet se a duhet raporti 2016 të jetë zyrtar për shqyrtim apo vetëm si informatë në Kuvend.

Enver Hoti - mendoj që propozimet që u bënë nga kolegët e tjerë paraprakë nuk janë në interes shumë të kësaj që po diskutohet. Është e qartë se në bazë të ligjit, këta raportojnë në Kuvend dhe mbikëqyrjen e këtij institucioni e bënë Kuvendi dhe ne duhet të merrim me këtë raport. Ne e dijmë që është Njësia e posaçme për ndërmarrjet publike në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, dhe në qoftë se ka nevojë që të kemi informata shtesë mund të bashkëpunojmë me Ministrinë, por raportimi duhet të bëhet.

Blerim Kuqi – nuk është problemi sa a duhet me shqyrtue raportin apo jo. Por kjo është një çështje ligjore dhe ne duhet vue rregulla për raportim, ashtu siç parashihet me ligj. Ne mund të kërkojmë raporte enkas, por po flasim për raporte të rregullat që i kanë rregullat e veta ligjore.

Kryetari - ne kemi formën standarde të raportimit financiar në komision, dhe do t'ua dërgojmë këta formular dhe ju si KOSTT do të mund ta përshtatni me specifikat e institucionit që keni dhe t'ia dërgoni komisionit këtë raport, sa më shpejtë që është e mundur. Po ashtu dy anëtarët e bordit që nuk kanë marrë pjesë në mbledhje të japin sqarime me shkrim për aryet e mungesës së tyre, dhe në mbledhjen tjetër të vini me formacion të plotë si bord.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. Shtyhet shqyrtimi i Raportit vjetor vjetor financiar të KOSTT SH.A. për vitin 2016, për një mbledhje tjetër të Komisionit.
2. Kërkohet nga KOSTT-i që të përgadisnin Raportin vjetor financiar për vitin 2016, sipas formularëve standard për raportim financiar të institucioneve dhe agjencive të pavarura në Kuvend dhe të dërgohet sa më shpejtë të jetë e mundur për shqyrtim në komision, në gjuhën shqipe dhe serbe.
3. Në mbledhjen e komisionit, kur do të shqyrtohet Raporti vjetor financiar i KOSTT për vitin 2016, kërkohet prezenca e tre anëtarëve të Bordit.

7. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për periudhën shtator-dhjetor 2017

Kryetari – raporti i punës së Komisionit paraqet aktivitetit që kemi zhvilluar gjatë priudhës shtator-dhjetor 2017. Kjo periudhe kohore ka qenë mjaftë intensive ku ne kemi mbajtur takime të shumëta.

Blerim Kuqi – unë mendojë është mirë që anëtarët e komisionit për buxhet dhe financa, të japin vetëm në këtë komision kontributin e tyre sepse është një punë jashtëzakonisht e madhe, një dinamik mjaftë e ngjeshur, sepse punët vetëm janë duke u shtuar dhe anëtarët e komisionit të jenë më të përkushtuar në punë, duke u nisur edhe nga vetëvetja.

Kryetari – siç po e shihni ne si komision, po kemi punë më tepër sesa komisionet tjera dhe si rezultat me miratimin e Buxhetit të Kosovës 2018, dhe ne kemi shtuar dy zyrtarë në komision dhe do të kërkojmë nga sekretari që të zhvillohen procedurat për rekrutimin sa më të shpejtë të tyre.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht miratoi Raportin e punës së Komisionit për periudhën shtator-dhjetor 2017.

8. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2018

Kryetari – ju keni marrë draft planin e punës së komisionit dhe ndër të tjera ju është propozuar që të mbahet një takim me Guvernatorin dhe Drejtorin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve, për çështjen e kartonit të gjelbërt, dhe takimi në draft plan është në shkurt, dhe unë propozojë të zhvendoset në prill, për shkak se tani jemi në procedurë të përzgjedhjes së guvernatorit të ri. Çështje tjetër është një takim i planifikuar me Bordin e Fondit Pensional, për të diskutuar lidhur me çështjen e nivelizimit të pagave të

menaxhmentit të Fondit. Ajo çfarë duhet të vendosim tani janë dy ligje që planifikojmë ti mbikëqyrim gjatë vitit.

Safete Hadërgjonaj – unë e kam një propozim që ta parashohim në periudhën kohore kur nuk jemi shumë të ngarkuar, që të kemi dëgjime buxhetore me ministritë dhe organizata tjera buxhetore, sepse kur po vie koha e buxhetit atëherë ne po ngarkohemi shumë me punë, dhe jo gjithmonë po kemi mundësi që ne ti përkushtohemi buxhetit të institucioneve përkatëse. Duke e pasur këtë dëgjim buxhetor me këto ministri e kemi shumë më lehtë që të marrim vendim në miratim të buxhetit në vitin e ardhshëm. Meqenëse roli jonë kryesorë është miratimi i buxhetit, atëherë duhet dhënë kontributin që buxheti i planifikuar dhe miratuar të shkojë në interes të qytetarit.

Naser Osmani - për mua është shumë me rëndësi që ta dijë se a do të punojmë sipas sistemit të raportimit që e kemi bërë me GIZ-in?

Kryetari - duhet të bëhet sistemi i raportimit. Unë do të kem me përfaqësuesen e GIZ-it një takim këto ditë takim dhe po ashtu do të bëjmë vizita së bashku të paraqiten mendime të reja në këtë drejtim.

Blerim Kuqi – theksoi se dijë që zonja Safete dhe zotëri Naseri kanë një përvojë dhe janë më të pregaditur në punën e komisionit, mirëpo është vështirë që ne të kërkojmë që komplet procesi i hartimit të buxhetit të vijë i tërë nëpërmjet komisionit, pasi që kjo mund të konsiderohet ndërhyrje në politikat buxhetore të qeverisë. Me sa e dijë unë procesi i përgaditjes së buxhetit është i hapur dhe ne mund të bëjmë një ndarje në mes vete për fushta e caktuara dhe ta përcjellim hartimin e procesit të buxhetit ta shohim se a është transparent. Ne duhet ta përcjellë procesin aty ku zhvillohet dhe jo të ndërhyjmë si komisioni sepse edhe ndoshta është në kundërshtim me ligjin.

Safete Hadërgjonaj - po me duket se jemi keqëkuptuar. Politikat e ministrisë i bënë ministria dhe ne aty nuk ndërhyrë. Nuk është fjala këtu që ne të ndërhyrë në buxhetin e tyre, mirëpo çështja është që ne të kemi informata që ku mundemi të kontribuojmë si komision. Pra, qëllimi kryesor është që ne ta shohim planifikimin se ku ka pasur ngecje realizimi i buxhetit, si po shkon dhe ne si komision çka mundemi të kontribuojmë në këtë drejtim. Ne si komision duhet që ti kemi informatat e nevojshme dhe se çfarë mundemi që ti ndihmojmë organizatave buxhetore që ti përfundojnë punët në interes të qytetarëve.

Blerim Kuqi - Qeveria e dërgon buxhetin në Kuvend, dhe ndërhyrjet tona si komision mund të bëjmë gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të tij. Mirëpo nga ajo që propozojë zonja Safete jam duke u friguar se kjo gjë është shumë ngarkesë për neve dhe ndoshta tani na duket e mirë, mirëpo në fund mund të na del jo praktike dhe jo e zbatueshme.

Safete Hadërgjonaj - theksoi se detyra e komisionit është që ta mbikëqyrim Qeverinë dhe kjo nuk është fare ngarkesë se ne këtë e kemi detyrë dhe kemi punë. Sa i përket përzgjedhjes së ligjeve për monitorim, unë propozojë që njëri të jetë Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, që është një ligj që kemi miratuar në vitin 2014 dhe pas ankesave, Gjykata Kushtetuese ka heqë pjesën e institucioneve mikrofinanciare. Ky problemi i mikrofinancave është një problem i pazgjidhur, mënyra e funksionimit të tyre nuk është e regulluar ende, ato realizojnë profit dhe nuk paguajnë tatim dhe duhet të gjindet një zgjidhje që ndoshta me monitorimin e këtij ligji ne do të kemi mundësi më shumë të marrim informata dhe në të vijnë në përfundim për rregullimin ligjor të kësaj fushe dhe nëqoftëse është nevoja ta ndryshojmë edhe Ligjin e OJQ-ve dhe ta zgjedhim këtë problem.

Blerim Kuqi – unë mendojë që edhe Ligji për fondet pensionale është i rëndësishëm, në këtë kuptim e kemi me të koncentruar rëndësinë e buxhetit dhe është më me rëndësi vitale edhe për shtetin tonë edhe

për neve që ky ligj të kontrollohet për shkak të rëndësisë dhe vëllimit që e ka. Propozojmë që të monitorojmë edhe këtë ligj.

Kryetari – konstatoi se komisioni gjatë vitit 2018 vendosi mbikëqyrjen e zbatimit të dy ligjeve: Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, të cilat do të jenë pjesë e planit të punës.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimitisht miratoi Planin vjetor të punës së Komisionit për vitin 2018, me plotësimet e bërë në mledhje.

9. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit të Bankës Qendrore për përzgjedhjen e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryetari – në bazë të Ligjit Bankën Qendrore, Bordi i Bankës Qendrore ka emëruar Panelin për përzgjedhjen e kandidatëve për guvernator të BQK-së. Paneli ka njoftuar se ka zhvilluar procedurat e konkursit dhe pas vlerësimit të integritetit, kualifikimeve profesionale dhe performancës së aplikantëve të ftuar për intervistë, ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret formale dhe profesionale që kërkohen me Ligjin e BQK-së. Si rrjedhojë, Paneli i ka dërguar Kuvendit listën me emrat e katër kandidatëve të përzgjedhur, për plotësimin e pozitës së Guvernatorit të BQK-së, dhe ata janë: Fehmi Mehmeti, Shkëndije Himaj, Besnik Bislimi dhe Safet Merovci. Qeveria brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, ka dërguar opinionin e saj dhe është deklaruar se pajtohet me kandidatët e propozuar nga Paneli për Guvernatorin të BQK-së. Në bazë të CV-ve të propozuara, shifet se kandidatët e propozuar i kushtet ligjore të përcaktuara Ligjin për Bankën Qendrore. Ti rekomandojmë Kuvendit, të përzgjedhë njërin nga katër kandidatët për pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore, me votim të fshehtë, i cili kandidatë i përzgjedhur i dërgohet Presidentit për miratim dhe emërim.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. I rekomandon Kuvendit, të përzgjedhë një kandidat për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, nga katër kandidatët e propozuar, si vijon:
 1. **Fehmi Mehmeti,**
 2. **Shkëndije Himaj,**
 3. **Besnik Bislimi,**
 4. **Safet Merovci.**
2. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, t'i dërgohet Presidentit për miratim dhe emërim në pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
3. Mandati i Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, është pesë vjeçar, në pajtim me nenin 38.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

10. Të ndryshme

Kryetari – siç jeni të njoftuar në mbledhjen e fundit ne kemi shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme dhe e kemi proceduar tutje, por i njëjti nuk ka arritur të

radhitet për shqyrtim në seancën e së enjtës, për shkak se komisioni për legjislacion tek dje e ka dërguar rekomandimin. Duke ditur nevojën për miratimin e këtij ligji brenda muajit janar, për shkak të donacionit nga qeveria suedeze, propozojë që të miratojë raportin final sot dhe në emër të Komisionit të propozojmë që futet si pikë shtesë në seancën plenare të së enjtes.

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Raportin final me rekomandime për Projektligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe vendosi që të kërkojë për plotësimin e rendit të ditës së Seancë Plenare dt. 25.01.2018, për shqyrtimin e dytë të këtij Projektligji, përmes shmangies së afateve procedurale, të parapara me nenin 15, paragrafin 7 dhe me nenin 57, paragrafin 9 të Rregullores së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:43

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

**Kryetari komisionit,
Lumir Abdixhiku**
